

	<b>KODI I RRJETIT</b>	<b>PO-KO-005</b>
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 1 nga 10</i>

## KODI I RRJETIT - KODI I KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri i Kompanisë	KOSTT	KOSTT	ZRrE
Data	22.11.2010	09.12.2010	10.09.2010

	<b>KODI I RRJETIT</b>	<b>PO-KO-005</b>
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 2 nga 10</i>

## PËRMBAJTJA

<b>1</b>	<b>Parathënie.....</b>	<b>3</b>
<b>2</b>	<b>Objektivat .....</b>	<b>4</b>
<b>3</b>	<b>Fushëveprimi.....</b>	<b>4</b>
<b>4</b>	<b>Rrethanat e paparashikuara .....</b>	<b>5</b>
<b>5</b>	<b>Rishikimi i Kodit të Rrjetit .....</b>	<b>5</b>
5.1	E përgjithshme .....	5
<b>6</b>	<b>Mosmarrëveshjet .....</b>	<b>6</b>
6.1	Të përgjithshme.....	6
6.2	Procedura e Mosmarrëveshjes .....	6
<b>7</b>	<b>Lirimi nga dispozitat .....</b>	<b>6</b>
7.1	E përgjithshme .....	6
7.2	Aplikimi për Lirim nga Dispozitat.....	6
7.3	Dhënia e Lirimit nga Dispozitat .....	7
7.4	Dështimi për Marrjen e një Lirimi nga Dispozitat.....	7
7.5	Dështimi i OSTT në përmbushjen e një Kushti të Kodit të Rrjetit.....	7
<b>8</b>	<b>Administratori i Kodit .....</b>	<b>8</b>
8.1	E Përgjithshme .....	8
8.2	Funksionet e Administratorit të Kodit .....	8
<b>9</b>	<b>Ruajtja e Fshehtësisë.....</b>	<b>8</b>
9.1	E Përgjithshme .....	8
<b>10</b>	<b>Komunikimi ndërmjet Palëve .....</b>	<b>9</b>
<b>11</b>	<b>Informatat e Përgjithshme .....</b>	<b>9</b>
<b>12</b>	<b>Burimet dhe Dokumentet .....</b>	<b>10</b>

	<b>KODI I RRJETIT</b>	<b>PO-KO-005</b>
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 3 nga 10</i>

## Kapitulli 2: Kodi i Kushteve të Përgjithshme

### 1 Parathënie

1.1.1.1 Secili seksion i veçantë i **kodit të rrjetit** përmban rregulla dhe dispozita që lidhen në mënyrë direkte me atë kod apo seksion të kodit. Kodet specifike për të cilat aplikohet ky **kod i kushteve të përgjithshme** janë si më poshtë:

- **Ky kod i kushteve të përgjithshme;**
- **Kodi i planifikimit;**
- **Kodi i kyçjes;**
- **Kodi i planifikimit operativ;**
- **Kodi i balancit;**
- **Kodi operativ;**

1.1.1.2 Ka disa dispozita që zbatohen përgjithësisht dhe që kërkohet të përfshihen në **kodin e rrjetit**. Këto dispozita i referohen të gjitha kodeve të mësipërme të cilat përfshijnë plotësisht **kodin e rrjetit** dhe janë të detajuara në këtë **kod të kushteve të përgjithshme**.

1.1.1.3 Termat që janë me shkrim të theksuar (bold) janë terma të përcaktuara dhe duhet të interpretohen sipas përkufizimit në **Përcaktimin e Termave të kodit të rrjetit**. Një fjalë e cila formon plotësisht apo pjesërisht një term të përcaktuar dhe nuk është me shkrim të theksuar nuk do të trajtohet si një term i përcaktuar.

1.1.1.4 Aty ku **Përcaktimi i Termave** i referohet ndonjë fjale apo termi që është përkufizuar në mënyrë më të hollësishme në një kod ose seksion të **kodit të rrjetit**, atëherë përkufizimi në atë kod ose seksion të **kodit të rrjetit** ka përparësi mbi përkufizimin e **Përcaktimit të Termave** në rast të ndonjë mospërputhjeje.

1.1.1.5 **Kodi i rrjetit** është shkruar në gjuhën angleze. Në rast të ndonjë mospajtimi, mospërputhje apo konfuzioni që shkaktohet ndërmjet origjinalit në anglisht dhe përkthimit në shqip atëherë versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

	<b>KODI I RRJETIT</b>	<b>PO-KO-005</b>
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 4 nga 10</i>

## 2 Objektivat

2.1.1.1 Objektivi i përgjithshëm i **kodit të kushteve të përgjithshme** është të sigurojë, me sa është e mundur, që seksionet e ndryshme të **kodit të rrjetit** bashkëveprojnë me kodet dhe rregullat e tjera të tregut për energjinë elektrike në Kosovë, për të mirën e punës së **Sistemit Energjetik** të Kosovës dhe për të gjitha **palët**.

2.1.1.2 Objektivi specifik i **kodit të kushteve të përgjithshme** është vënja e rregullave për t'u përballur me situatat e mëposhtme:

- Situatat e paparashikuara të përmendura në seksionin 4;
- Menaxhimin e **kodit të rrjetit** duke përfshirë procedurat për t'u ndjekur për propozimin, bërjen dhe zbatimin e ndryshimeve;
- Derrogimet nga të cilat një **palë** nuk mund të përmbushë kërkesat që dalin nga **kodi i rrjetit** ;
- Mosmarrëveshjet;
- Administratorin e Kodit;
- Ruajtjen e fshehtësisë;
- Komunikimet ndërmjet **palëve**.

## 3 Fushëveprimi

3.1.1.1 **Kodi i kushteve të përgjithshme** përdoret për:

- **OSTT**;
- **Operatorët e sistemit të shpërndarjes (OSSh-të)**;
- **Gjeneruesit**;
- Të gjitha **palët** e tjera që operojnë në **Sistemin Energjetik** të Kosovës të cilat janë të lidhura me kërkesat e **kodit të rrjetit**;
- **Rregullatorin**:

	<b>KODI I RRJETIT</b>	<b>PO-KO-005</b>
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 5 nga 10</i>

## 4 Rrethanat e paparashikuara

- 4.1.1.1 Nëse paraqiten rrethana të cilat nuk janë të parashikuara në mënyrë të arsyeshme nga **kodi i rrjetit, OSTT**, sipas mundësisë dhe në mënyrë të arsyeshme me rrethanat, duhet të konsultohet menjëherë me të gjitha **palët** e dëmtuara duke u përpjekur të arrijë marrëveshje se çfarë veprimesh duhen ndërmarrë, nëse duhet. **OSTT** duhet të njoftojë **palët** dhe **rregullatorin** për vendimin e tij dhe për arsyet e këtij vendimi sa më shpejt të jetë e mundur.
- 4.1.1.2 Sa herë që **OSTT** të ndërmerret një vendim, kur është e mundur, atë duhet ta ndërmerret duke pasur parasysh pikëpamjet e shprehura nga **palët** e tjera, dhe në ndonjë rast, atë që është e arsyeshme në të gjitha rrethanat.
- 4.1.1.3 Çdo **palë** do të përmbushë të gjitha udhëzimet e dhëna për të nga **OSTT** pas marrjes së vendimit, se udhëzimet janë në pajtueshmëri me funksionimin e vazhdueshëm e të sigurt të **sistemit** të **palës**. **OSTT** do t'ia referojë menjëherë rrethanat e paparashikuara dhe vendimet e tilla, komisionit qeverisës të kodeve operative (**KQKO**) për konsiderim në përputhje me paragrafin 5 të **kodit të kushteve të përgjithshme**.

## 5 Rishikimi i Kodit të Rrjetit

### 5.1 E përgjithshme

- 5.1.1.1 **Kodi i rrjetit** përcakton kushtet të cilat duhet të hartohen me të gjitha **palët**. Rishikimet e **kodit të rrjetit** do të ndërmerren nga komisioni qeverisës i kodeve operative (**KQKO**) sipas “Rregullit mbi Procedurat e Qeverisjes për Kodet Teknike/Operacionale” të miratuara nga **Rregullatori**. **OSTT** do të marrë përgjegjësinë për inkorporimin e amendamenteve (ndryshimeve) të dakorduara nga **KQKO** dhe të miratuara nga **Rregullatori** dhe për nxjerrjen në qarkullim të kodit të amenduar (ndryshuar).

	<b>KODI I RRJETIT</b>	<b>PO-KO-005</b>
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 6 nga 10</i>

## 6 Mosmarrëveshjet

### 6.1 Të përgjithshme

6.1.1.1 **Kodi i rrjetit** përmban rregulla të cilat janë të detyrueshme dhe në përgjithësi janë specifike për të mbuluar shumicën e rasteve që kanë gjasa të ndodhin në fushat e mbuluara nga **kodi i rrjetit**. Të gjitha **palët**, gjatë implementimit të këtyre rregullave duhet të veprojnë gjithnjë në mirëbesim. Qëllimi duhet të jetë që të përpiqemi dhe të sigurojmë sa më shumë që të jetë e mundur që të mos ndodhin mosmarrëveshje.

### 6.2 Procedura e Mosmarrëveshjes

6.2.1.1 Mosmarrëveshjet që vijnë si rezultat i operimit të **kodit të rrjetit** do të zgjidhen në përputhje me “Rregullin mbi Procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve” të miratuara nga **Rregullatori** për mosmarrëveshjet mes palëve në tregun e energjisë.

## 7 Lirimi nga dispozitat

### 7.1 E përgjithshme

7.1.1.1 Të gjitha **palët** e lidhura nëpërmjet termave të **kodit të rrjetit** duhet të zbatojnë dispozitat e tij në të gjitha aspektet relevante. Aty ku një **palë** në **kodin e rrjetit** nuk mund t’i përmbahet plotësisht kërkesave të **kodit të rrjetit** atëherë ajo **palë** duhet të kërkojë një lirim nga dispozitat.

### 7.2 Aplikimi për Lirim nga Dispozitat

7.2.1.1 Sapo një **palë** e shikon se nuk është në gjendje të përmbushë plotësisht një ose më shumë kushte të **kodit të rrjetit** atëherë ajo **palë** duhet të informojë menjëherë **OSTT** dhe të kërkojë një lirim nga dispozitat. Kërkesa do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Kushtet që nuk mund të përmbushen;
- Arsyeja për pamundësinë e përmbushjes së kushtit;
- Sa shpesh ky kusht nuk mund të përmbushet – d.m.th. plotësisht, me raste etj;
- Ndikimi në dështimin e përmbushjes së kushtit të veçantë;

- Data e përafërt se kur kushti mund të përmbushet plotësisht:

7.2.1.2 Lirimet nga dispozitat duhet të aplikohen për çdo vend apo në çdo njësi<sup>1</sup> të stabilimentit dhe nën asnjë rrethanë nuk do të lejohen lirime mbulesë nga dispozitat që mbulojnë vende të ndryshme dhe lloje të ndryshëm **njësish gjeneruese** ose pajisjesh të tjera.

### 7.3 Dhënia e Lirimit nga Dispozitat

7.3.1.1 **OSTT** do të konsiderojë të gjitha faktet në vendimmarrje nëse do të lejohet apo jo një lirim nga dispozitat dhe do ta japë vendimin brenda [një] muaji. Përveçse në rrethana të jashtëzakonshme një lirim nga dispozitat do të mbetet në fuqi për një periudhë maksimale prej [tre] vitesh pas së cilës do të kërkohet një ri-aplikim.

### 7.4 Dështimi për Marrjen e një Lirimi nga Dispozitat

7.4.1.1 Në qoftë se një **palë** nuk mundet t'i përmbushë kërkesat e **kodit të rrjetit** dhe dështon në marrjen e një lirimi nga dispozitat atëherë do të aplikohen sanksionet e mëposhtme:

- Ai do të marrë një paralajmërim me shkrim prej **OSTT**;
- Në qoftë se situata nuk rregullohet brenda [dy] muajsh nga marrja e paralajmërimit të mësipërm do të lëshohet një paralajmërim final;
- Nëse brenda [dy] muajsh të tjera situata nuk është rregulluar atëherë **OSTT** do të konsultohet me **Rregullatorin** dhe do të aplikojë një sanksion që variron nga një gjobë monetare deri në shkyçjen nga **sistemi**:

### 7.5 Dështimi i OSTT në përmbushjen e një Kushti të Kodit të Rrjetit

7.5.1.1 Në qoftë se **OSTT** nuk mundet të përmbushë të gjitha kushtet e **kodit të rrjetit** atëherë **OSTT** duhet të informojë **Rregullatorin** sa më shpejt të jetë e mundur dhe në asnjë rrethanë më tepër se [14] ditë nga dita kur është vërejtur gjendja.

---

<sup>1</sup> Në rast të një **stabilimenti** të energjisë ku dy ose më shumë **njësi gjeneruese** dështojnë në përmbushjen e të gjitha kushteve të **kodit të rrjetit** dhe ka një arsye të përbashkët për këtë dështim atëherë mund të aplikohet për një lirim të vetëm nga dispozitat dhe ai mund të miratohet. Aty ku një **stabiliment** energjetik ka **njësi gjeneruese** që nuk janë identike atëherë duhet të dorëzohet një aplikim për lirim nga dispozitat për secilin tip.

	<b>KODI I RRJETIT</b>	<b>PO-KO-005</b>
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 8 nga 10</i>

7.5.1.2 **Rregullatori** do të konsultohet me **OSTT** dhe me këdo tjetër që e konsideron të nevojshëm dhe brenda [28] ditësh do të dakordohet veprimi që duhet ndërmarrë.

## 8 Administratori i Kodit

### 8.1 E Përgjithshme

8.1.1.1 **OSTT** duhet të veprojë si administrator kodi dhe si i tillë duhet të ndërmarrë të gjitha funksionet e detajuara më poshtë në mënyrë profesionale dhe jo diskriminuese në afatin kohor .

### 8.2 Funksionet e Administratorit të Kodit

8.2.1.1 Funksionet e administratorit të kodit do të përfshijnë si më poshtë:

- Mbajtjen e kopjes kryesore të azhurnuar të **kodit të rrjetit** duke siguruar se janë përfshirë të gjitha rishikimet e miratuara në të;
- Postimin (shpalljen) e versionit aktual të miratuar në internet;
- Postimin (shpalljen) e ndryshimeve të propozuara në internet (për konsultime);
- Postimin (shpalljen) e ndryshimeve të miratuara në internet;
- Informimin, me shkrim, të të gjitha **palëve** të cilat janë regjistruara me **OSTT** për këtë informacion se ka pasur ndryshime të propozuara, të miratuara ose versione të reja të **kodit të rrjetit** që janë të gatshme në internet.

## 9 Ruajtja e Fshehtësisë

### 9.1 E Përgjithshme

9.1.1.1 Për ti zbatuar plotësisht dispozitat e **kodit të rrjetit**, është e rëndësishme që të respektohet plotësisht ruajtja e fshehtësisë së të dhënave.

9.1.1.2 Të gjitha të dhënat dhe informacionet e shkëmbyera ndërmjet **palëve** në **kodin e rrjetit** dhe që kërkohen prej tyre në mënyrë që të përmbushin detyrimet e tyre sipas

	<b>KODI I RRJETIT</b>	<b>PO-KO-005</b>
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 9 nga 10</i>

**kodit të rrjetit** duhet të trajtohen si informacion konfidencial përveçse nëse janë marrë vesh ndryshe.

9.1.1.3 Të dhënat dhe informacionet e shkëmbyera për një qëllim të caktuar duhet të përdoren vetëm për atë qëllim përveçse kur të dyja **palët** merren vesh ndryshe.

9.1.1.4 **OSTT** lirohet prej obligimeve sipas këtij seksioni kur të dhënat duhet të ofrohen ose nëpërmjet raportimit të rregullt ose me kërkesë nga qeveria, **Rregullatori**, gjykatat dhe institucione të tjera shtetërore, bazuar në rregullat ekzistuese ose në procedimet ligjore. Në këto rrethana **OSTT** obligohet të njoftojë **palën** që i ka dorëzuar të dhënat relevante në secilin rast.

## 10 Komunikimi ndërmjet Palëve

10.1.1.1 Përveçse nëse është specifikuar ndryshe në **kodin e rrjetit**, të gjitha instruksionet e dhëna nga **OSTT** dhe komunikimet ndërmjet **OSTT** dhe **palëve** të tjera do të kryhen ndërmjet stafit në qendrën e kontrollit të **OSTT** dhe stafit të njoftuar në **OSTT** nga secila **palë** tjetër.

10.1.1.2 Përveçse nëse është specifikuar ndryshe në **kodin e rrjetit**, të gjitha udhëzimet e dhëna nga **OSTT** dhe komunikimet ndërmjet **OSTT** dhe **palëve** të tjera do të kryhen me telefon ose me shkrim (shiko seksionin 11). Aty ku udhëzimet jepen me telefon, nëse e kërkon ndonjëra nga **palët** atëherë ato duhet të mbështeten me një konfirmim të shkruar.

10.1.1.3 Nëse qendra e kontrollit e **OSTT** ose qendra e kontrollit e një **pale** tjetër zhvendoset në një vend tjetër, për shkak të një emergjence ose për ndonjë arsye tjetër, **OSTT** ose **pala** tjetër, aty ku është e nevojshme, duhet ta njoftojnë njëra tjetrën për vendndodhjen e re sa më shpejt që të jetë e mundur pas zhvendosjes.

## 11 Informatat e Përgjithshme

11.1.1.1 Brenda këtij dokumenti disa fjalë dhe fraza të caktuara kanë kuptimet e mëposhtme:

- Referimet në gjininë mashkullore do të përfshijnë edhe gjininë femërore dhe referimet në njëjës do të përfshijnë referimet në shumës dhe anasjelltas;

- Aty ku **kodi i rrjetit** specifikon dhënien e informacioneve me shkrim ose konfirmim me shkrim, atëherë çdo lloj tjetër mjeti transferimi elektronik që lejon marrësin ta ruajë këtë informacion – si posta elektronike apo Faksi– e përmbushin këtë kërkesë;
- Përveçse në rastet kur thuhet ndryshe në mënyrë të hapur, të gjitha referimet për seksionet do të jenë referime për seksione në **kodin e rrjetit**;
- Përveçse në rastet kur thuhet ndryshe në mënyrë të hapur, të gjitha referimet për paragrafë do të jenë referime për paragrafët në **kodin e rrjetit**.

## 12 Burimet dhe Dokumentet

### 12.1 Burimet

Nr.	Emri i dokumentit
1.	Ligji për Energjinë Elektrike
2.	Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit
3.	
4.	

### 12.2 Dokumentet dhe formularët

Derrogimet

### 12.3 Shënime për versionet

Versioni	Data	Përshkrimi	Kohëruajtja
1.1	27.01.2007	Edicioni 1, Rishikimi 1	1 vit
2.0	14.01.2008	Edicioni 2	2 vjet
2.1	10.09.2010	Edicioni 2, Rishikimi 1	